

FJALA E DEPUTETIT GAZMENT BARDHI

E ENJTE 24 NËNTOR 2022

Në fakt, më në fund, një prej kolegëve socialistë e tha se çfarë merr shteti shqiptar nga gjithë kjo kontratë. I paskemi ofruar gjithçka investitorit dhe na paska dhënë të drejtën e fjalës! Të paktën investitori ta dhënka të drejtën e fjalës, sepse ju keni filluar të na hiqni edhe të drejtën e fjalës, madje sot në mëngjes na u deshën dy orë që opozita të fitonte të drejtën e fjalës në parlament. Të dashur bashkëqytetarë, ju e dini që prej 9 vjetësh kemi në këmbë qeverinë, e cila ka propagandën më të zhvilluar që ka pasur ndonjëherë një qeveri në 30 vjet.

Nëse ky do të ishte projekti më i bukur, kontrata më e mirë, që ofron përfitimet më të mira për shtetin shqiptar, do të kishit dëgjuar këto 6 orë atë që konkretisht përfitojnë qytetarët dhe shteti shqiptar nga kjo kontratë, që ka ardhur për miratim në Kuvendin e Shqipërisë. Foli Kryeministri, shau opozitën; foli zëvendëskryeministrja, shau opozitën; foli ministrja e Financave, shau opozitën dhe askush nuk dëgjoji nga ju të thoshit se çfarë fiton shteti shqiptar apo qytetarët e Durrësit nga kjo kontratë. Për të thënë nëse është një kontratë e mirë apo jo, do të duhet t'i referohemi kontratës. Deri tani, qoftë nga qeveria, qoftë nga kolegët e PS-së kemi dëgjuar vetëm emrin Alabbar, a thua se mjafton që ky Kuvend t'i hapë dritën jeshile kësaj kontrate!

Absolutisht që Alabbar-i është një personalitet i njohur edhe i nderuar në fushën e vet, askush nuk ka asgjë me të, por nëse kjo kontratë është e mirë apo jo për qytetarët shqiptarë, nëse kjo kontratë do të duhet të votohet apo jo, kjo bëhet me analiza se çfarë ofrojmë ne si shtet dhe çfarë përfitojmë. Çfarë ofron konkretisht shteti shqiptar me këtë kontratën më të mirë historike, që ka sjellë ndonjëherë në parlament, siç thonë dhe kanë cituar të gjithë kolegët e këtij krahu këtej gjatë këtyre 6 orëve? Shteti shqiptar i vendos në dispozicion 812 mijë metra katrorë tokë. Kanë gjithë ditën që përsërisin një gënjeshtër se pronësia do të mbetet në shtet, dhe shteti nuk ia kalon investitorit strategjik këtë pronë. Dëgjova Kryeministrin, i cili tha: “Po të kishit qenë ju, do t’ia kishit dhënë tokën me 1 euro”.

Në fakt, po të lexosh kontratën, pikën 10/1.1, thuhet se me 1 euro i jepet toka investitorit, zonja Zëvendëskryeministre. Ju gënjeni, ndërkohë që ne letrat i kemi përpara dhe janë publike. Po jua lexoj: “Investitori strategjik do të ketë të drejtë të konvertojë parcelën ndërtimore në pronësi të lirë (pronësi të plotë) për pagesën nominale prej 1 eurosh për shtetin shqiptar”. Pra, tokën ia jepni me 1 euro. Në

pikën 10/1.4, zonja Zëvendësministre, thuhet: "...dhe pasi zhvillon, pasi investitori strategjik merr certifikatën e titullit të një parcele ndërtimore, është ai që ka të drejtë t'ua shesë dhe t'ua transferojë titullin e truallit palëve të treta". Pra, investitori shet pronën publike. Qenka gënjeshtër që ne nuk ia japim në pronësi tokën investitorit strategjik!

Së dyti, shteti shqiptar merr përsipër nga kjo kontratë t'i vendosë në dispozicion të gjithë infrastrukturën ekzistuese të portit. E kanë qeverisur vendin për 17 vjet, ndër të cilat 10 vjetët e fundit pa ndërprerje, dhe sot kanë gjithë ditën që shajnë dhe mallkojnë portin e Durrësit. Kanë kryer atje me miliona euro investime, edhe kohët e fundit, dhe e nxjerrin portin më të madh në vend, një nga më të rëndësishmit në rajon, skarco, jashtë përdorimit. Pra, kur ju duhet këtyre për ta falur, e nxjerrin edhe portin jashtë përdorimit. Do t'i japin investitorit 220 milionë euro kontribute nga falja e taksave. Kanë gjithë ditën që thonë se kanë marrë 33% të aksioneve në shoqëri. Nuk i keni marrë, i keni dhënë 220 milionë euro në këmbim të këtyre aksioneve, që keni marrë shoqërinë e përbashkët. Ndërkohë, investitori, që merr 67% të aksioneve, ka vënë në dispozicion që në fillim të projektit dhe gjatë gjithë zhvillimit të projektit vetëm 79,7 milionë euro.

Ndërkohë, ju e dini që taksa e ndikimit në infrastrukturë, që është në masën 160 milionë euro, do të paguhej përpara zbardhjes së lejes së ndërtimit, nëse do të zbatohet ligji. Pra, është një kontribut i menjëhershëm që jep shteti shqiptar. Kjo zbulohet nga fakti që nuk keni kërkuar ju të jeni pjesë e kësaj shoqërie, vetë e keni thënë sot gjithë ditën, por ishte kërkesë e investitorit strategjik, që shteti të ishte palë në këtë shoqëri investimi. Pse? Sepse kishte nevojë për paratë tuaja. Ai do të vendosë vetëm 80 milionë euro në dispozicion të këtij projekti. Nëse ju nuk do të ishit palë e kësaj shoqërie me 33% të aksioneve, atëherë do të duhej që ky investitor të paguante 160 milionë euro qysh në fillim të këtij projekti. Nuk i ka në dispozicion të këtij projekti dhe prandaj ju ka thënë të futeni si aksionarë në këtë shoqëri, sepse ka nevojë për këtë kontribut të menjëhershëm. Ku është favori që ka marrë shteti shqiptar këtu? Çfarë përfiton tjetër investitori? Shfrytëzim të hapësirave publike dhe të plazhit për 35 vjet.

Kanë gjithë ditën sot që thonë se do të bëjnë 700 metra linear plazh publik e me radhë. Është gënjeshtër! Sipas kontratës, pikës 10/9 të marrëveshjes, për 35 vjet do të jetë investitori ai që do të menaxhojë, do të operojë, do të zhvillojë dhe do të lejojë, sipas kushteve të tij, aksesin e publikut në këto plazhe. Pra, qytetarëve të Durrësit do t'u duhet të paguajnë për të shfrytëzuar këto plazhe. Kanë gjithë ditën që thonë se investitori do të ndërtojë caq mijë metra katrorë hapësirë publike. Edhe kjo është një gënjeshtër, se në pikën 10/6.1 thuhet që për 35 vjet është investitori ai që do të përdorë

atraksionet publike kundrejt tarifave, duke i shfrytëzuar me kioska, me reklama, me pika ushqimi, me pika pijeje e me radhë. Kjo thuhet në kontratë, pra nuk janë hapësira që i vihen në dispozicion publikut.

Keni marrë përsipër të ndërtoni infrastrukturën e shërbimeve mbështetëse dhe furnizimet me shërbime komunale, thënë ndryshe, do t'i çoni rrjetin e ujësjellësit, rrjetin e energjisë elektrike, rrugët që të çojnë te ky projekt që do të zhvillohet, dhe të gjitha këto i paguan shteti shqiptar. Keni marrë përsipër kostot për lirim fizik dhe pastrimin mjedisor, pra do t'ia bëni gati sheshin për zhvillim investitorit. E di sa mund të shkojë kjo kosto, sipas parashikimeve që keni bërë vetë në kontratë? Kjo kosto mund të shkojë edhe sa vlera e dividendit, e fitimit që mund të marrë shteti shqiptar nga futja si bashkaksionar në këtë shoqëri tregtare. Keni marrë përsipër kostot e transferimit të portit ekzistues, keni marrë përsipër kostot e shpronësimeve të mundshme apo të pretendimeve të palëve të treta mbi pronësinë në këtë truall dhe, së fundi, keni humbur sot edhe 28 milionë euro grant nga Bashkimi European. Çfarë fitojmë?

Të dashur bashkëqytetarë, nga kjo kontratë kemi të sigurt vetëm 200 mijë euro në vit, asnjë lek tjetër nuk është i garantuar nga kjo kontratë. Dividenti mund të jetë, sipas kontratës, në vlerën e kostove që do të paguajë Eagle Hills, për lirim fizik dhe pastrimin mjedisor. Kështu që e vetmja gjë e sigurt, pasi ka ofruar gjithë këtë listë të gjatë, që unë e përmenda, që përfiton shteti shqiptar nga kjo kontratë, janë vetëm 200 mijë euro në vit. Pra, po falim 812000 metra katrorë tokë, po falim infrastrukturën e portit të Durrësit për të marrë në këmbim vetëm 200 mijë euro në vit! Ndaj, kjo nuk mund të jetë kurrë kontrata më e mirë që ka ardhur në këtë parlament, përkundrazi, është kontrata më e keqe që shteti shqiptar ka bërë ndonjëherë me një privat, një kontratë nga e cila dëmtohet interesi publik. Prandaj vota ime dhe e kolegëve të mi do të jetë kundër. Faleminderit!